

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E HËNË 3 TETOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

E kërkova fjalën për të kthyer përgjigje për disa nga shqetësimet e kolegëve të opozitës. Doja ta nisja me shqetësimin e ngritur nga zonja Bakiu në lidhje me mbylljen e kolegjit turk “Mehmet Akif”. Në fakt, do të doja që zonja të ishte në sallë, sepse erdhi, lexoi fjalimin, u kthye mori çantën dhe iku. Mendova se ngriti një shqetësim konkret dhe donte përgjigje; mendova se e kishte seriozisht, ndaj do të ishte mirë që të ishte këtu në sallë. E kuptova që nuk e kishte seriozisht qëkur nuk kishte lexuar relacionin, sepse tha se vendimi nuk ka argumente. Në fakt, nuk i ka vendimi argumentet, por të gjitha argumentet ligjore i ka relacioni që shoqëron vendimin Këshillit të Ministrave.

Kështu që edhe në përgjigje të zonjës, por edhe për ju, jam e detyruar të jap disa shpjegime. Menjëherë pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, unë kam reaguar dhe i kam argumentuar të gjitha arsyet, por nuk kam folur shpesh në medie, sepse kjo është një çështje ligjore, administrative, teknike dhe nuk duhet që të marrë përmasa politike. Pas gjithë atyre që lexova e dëgjova, por edhe pas reagimit tuaj, po e shfrytëzoj këtë seancë për të dhënë edhe më shumë shpjegime. Së pari, nxënësit, familjet e tyre dhe mësuesit e shkollës, por edhe opinionin publik (në fakt, të vetmit që i mirëkuptoj në këtë histori janë nxënësit dhe familjet e tyre, që me siguri janë familjarizuar në një mjedis të caktuar dhe e kanë të vështirë të lëvizin drejt një shkolle tjetër) që në fillim dua t’i garantoj që ne po bëjmë maksimumin dhe do t’u ofrojmë të gjitha mundësitë për t’i akomoduar dhe për t’i përshtatur ata në shkolla të tjera, qoftë pranë vendbanimeve të tyre apo edhe sipas preferencave që ata kanë.

Po punojmë maksimalisht në këtë drejtim bashkë me zyrën arsimore, por edhe me prindërit dhe me nxënësit. Ndërkohë, ata që nuk i mirëkuptoj aspak, janë ata politikanë që duan të bëjnë

protagonizëm, duke bërë ekspertin në çdo fushë, të cilët, pa lexuar as faktet, as arsyet, as ligjin dhe asgjë, japin verdiktin, siç bëri edhe zonja pak më parë, gjithçka në shërbim vetëm të interesave të tyre personale, të vogla apo partiake. E gjithë historia është çështje e zbatimit të ligjit. Një institucion, në këtë rast një institucion privat, ka shkelur ligjin. Ka shitur godinën për arsye fitimi dhe i kanë marrë nxënësit në fillim të vitit shkollor e i ka dërguar në një godinë tjetër, pa marrë certifikimin nga Ministria e Arsimit nëse godina i plotëson standardet për nxënësit, pa bërë verifikimet përkatëse dhe asgjë tjetër.

Në cilin vend të botës ndodh që një institucion, aq më tepër një institucion arsimor, ku bëhet fjalë për fëmijët tanë, e shet godinën për qëllime të tij?! Shumë mirë bën, se ka të drejtën e tij, por jo t'i dërgojë fëmijët në një godinë tjetër, pa u bërë verifikimi nga institucionet përkatëse dhe pa plotësuar standardet. Kjo është ajo që ka ndodhur dhe për këtë shkelje ligji parashikon heqjen e licencës. Si mund të ankoheni ju që ministria apo qeveria po zbaton ligjin, se ju këtë po thoni: "Pse po zbatoni ligjin?!"? Si mund t'u dilni ju në mbrojtje shkelësve të ligjit, për më tepër kur bëhet fjalë për fëmijët?! Detyra jonë primare është t'i inkurajojmë të gjitha institucionet dhe të gjithë qytetarët që të zbatojnë ligjin dhe jo të bëjnë të kundërtën.

Pra, në radhë të parë, është detyrimi ynë si ligjbërës që të inkurajojmë njerëzit që të respektojnë ligjin. Këtë procedurë dhe si ky vendim ne kemi marrë edhe më parë, sepse në çdo rast kur shkelet ligji, vepron ligji. Para pak muajsh kemi mbyllur një institucion arsimor në Fier përsëri për të njëjtën arsye, sepse ka shkelur ligjin dhe u respektua ligji. Pse nuk reaguat ju atëherë, se nuk dëgjova asnjë nga ju të reagonte?! Unë nuk dua të mendoj që ju nuk reaguat, se atje ishin njerëz të thjeshtë, familje të thjeshta, kurse këtu njerëzit janë më të rëndësishëm, janë biznesmenë. Si është e mundur? Është një institucion privat, cilido qoftë pronari, shqiptar, turk, grek e kushdo qoftë, të gjithë jemi të barabartë përpara ligjit dhe të gjithë duhet ta zbatojmë e ta respektojmë në mënyrë të barabartë.

Në fakt, unë kam marrë mesazhe edhe nga ish-nxënës të shkollës, madje mesazhe të tilla që thoshin: si e mbyllët shkollën, na fshitë historinë?! Natyrisht, ata mund të kenë kujtime të bukura dhe nuk e vë fare në dyshim, por, në fakt, më kujtuan shkollën time. Në atë kohë unë e kam bërë shkollën 8- vjeçare në mes të lagjes "Kala" dhe ka qenë shkolla "Kostandin

Kristoforidhi". Pas viteve '90 shkollës i doli pronari dhe, në zbatim të ligjit, shkolla sot nuk ekziston më, sepse godina dhe prona iu dha pronarit. Ne nuk protestuam dhe mua nuk më vjen keq. Në atë shkollë kam studiuar unë; kanë studiuar pasardhës të familjeve Shuteriqi, Krisoforidhi, Todri e të gjithë, por ne nuk dolëm në protestë pse na e mbyllën shkollën.

Shkolla u mbyll, sepse u respektua ligji. E solla këtë si shembull, sepse m'u kujtua nga mesazhet pafund, të cilat më thoshin: si na e mbyllët shkollën, si na mbyllët historinë, si na e fshitë historinë?! Unë kam marrë shumë mesazhe të tilla, por është vetëm çështje e respektimit të barabartë të ligjit nga të gjithë, kushdo qoftë. Në fund dy fjalë për pronarët e shkollës: keqardhje që jashtë kamerave apo në zyrat e ministrisë e pranojnë, që kanë shkelur ligjin, por kërkojnë zgjidhje, ndërsa, kur dalin në medie bëjnë, si viktimë, duke përdorur edhe fëmijët; e justifikojnë shkeljen e ligjit, sepse, sigurisht, që kanë detyrime para prindërve dhe para nxënësve që i lanë në mes të rrugës.

Unë e përsëris edhe një herë: ne për nxënësit dhe familjet e tyre do të bëjmë maksimumin që t'i akomodojmë në shkolla më të përshtatshme, qoftë pranë vendbanimeve të tyre apo edhe në shkollat që ata preferojnë. Dy fjalë për shqetësimet e tjera, që ngritën kolegët deputetë, Saimir Korreshi dhe kolegu Sula në lidhje me shkollën në Peqin. I kam të gjitha informacionet dhe bëhet fjalë për shkollën e Shezës, që ka 116 nxënës, të cilët janë transferuar në shkollën e Pekishtit që ka 83 nxënës. Në bashkëpunim me bashkinë e qytetit janë marrë të gjitha masat që nxënësve t'u garantohet dhe t'u rimburohet transporti. Shkolla është vetëm 3 deri 4 kilometra larg dhe mësimi po zhvillohet normalisht, sepse shkolla e re i ka kapacitetet e plota.

Ky është informacioni që unë kam, të cilin patjetër do ta verifikoj edhe një herë, por në komunikimin me bashkitë, sepse ju duhet ta dini se edhe bashkitë kanë kompetencat e tyre në lidhje me administrimin e infrastrukturës shkollore, të koordinojmë në çdo rast për të gjetur zgjidhjen më të mirë, që nxënësit të jenë të sigurt, t'u garantohet jeta dhe shëndeti, dhe ndërkohë t'u garantojmë edhe transportin, autobusin, koston, rimbursimin e biletës e të tjera. E njëjta gjë edhe për rastin e shkollës në Golem. Për nxënësit e shkollës "Herakli Bozo", që janë transferuar në shkollën "Jani Nushi", distanca është vetëm 3 kilometër larg. Orari është koordinuar.

Kolegu Korreshi më drejtoi pyetjet, por nuk e shikoj në sallë. Në orën 11:30 transferohen me autobus klasat nga e para në të pestën dhe në orën 11:45 klasat nga e gjashta në të nëntën. Mësimi fillon në orën 12:30. Pra, kemi informacion të plotë dhe i kemi marrë të gjitha masat në koordinim me bashkinë, në koordinim me zyrën arsimore dhe në koordinim me familjet dhe vetë nxënësit.